



BASHKOHUNI ME NE

UDHËHEQJA E POPULLIT

OLTI (10), ELTON (10), VALMIR (10), RREZE (10), SUELA (10), ELSA (10), ERNOJA (10)



Gazetarët e ditës së sotme

Një ditë, një nxënës i ri trokiti në klasën tonë. Mësojeni çfarë ndodhi

Ishte ditë dimri. Mësuesja na kishte paralajmëruar se do të vinte një nxënës i ri në klasën tonë. Ky nxënës vinte nga një shtet i largët në Afrikë dhe ishte duke mësuar gjuhën shqipe. Mezi po prisnim ta takonim. Pikërisht në atë ditë dimri, hyri brenda një moshatar i yni. Ai ishte i ndrojtur dhe ndihej i huaj. Mirëpo, ne menjëherë e pritëm me ngrohtësi dhe e trajtuam siç e trajtojmë njëri-tjetrin. Për neve nuk ka rëndësi ngjyra e lëkurës, besimi, kombi, apo gjinia.

Ne jemi qytetarë të një shteti demokratik, siç është Kosova. Prandaj, ne sillemi me shumë respekt ndaj të gjithëve, sepse demokracia na mëson t'i trajtojmë të gjithë në mënyrë të barabartë. Në anën tjetër, ne gjithashtu jetojmë në bazë të elementeve të demokracisë. Këto elemente janë: respekti, toleranca, solidariteti, paqja, etj.

Demokracia gjithashtu e ka një dhuratë shumë të këndshme për ne. Në këtë dhuratë, përfshihen të drejtat që ne i kemi si qytetarë. Këto të drejta janë: e drejta e shkollimit, e votës, e shprehjes së lirë, etj. Këto të drejta na bëjnë që ne populli të jemi udhëheqës në demokraci. Prandaj, edhe thuhet se demokracia është udhëheqje e popullit. Këtu po ndahemi nga ju, duke shpresuar që artikulli ynë ju ka ndihmuar të kuptoni rëndësinë që demokracia ka në jetën tonë.



Demokracia, ky sistem i bukur me ngjyra

SHTËPIA E LIGJEVE

ANILA (11), ERIS (10), ANDUENA (10), MENTOR (10), ARIANA (10), SHEREMET (10), SARA (10),

DONAT (10)



Për ta kuptuar lidhshmërinë e qytetarëve me Kuvendin, lexojeni artikullin tonë më poshtë

Ne jemi disa qytetarë, të cilët jetojmë në një shtet demokratik, që quhet Kosovë. Ne kemi shumë të drejta, por disa prej këtyre të drejtave nuk na lejohet ti përdorim para moshës 18 vjeçare. Është fjala për të drejtën e votës, e cila na mundëson që t'i zgjedhim përfaqësuesit e shtetit. Këta përfaqësues janë 120 deputetët prej të cilëve 100 janë shqipëtarë dhe 20 të tjerë u takojnë komuniteteve të ndryshme jo shumicë siç janë: serbët, romët, turqit, ashkalinjtë, egjiptianët boshnjakët dhe goranët.

Deputetët punojnë në Kuvendin e Kosovës, institucion i cili ka disa funksione shumë të rëndësishme. Këto funksione janë: përfaqësimi i popullit, miratimi apo mosmiratimi i ligjeve, si dhe kontrollimi i punës së Qeverisë.

Kuvendi ka një ndikim të madh në jetën tonë, sepse ligjet të cilat miratohen nga deputetët e rregullojnë mënyrën e jetesës sonë. Ne kemi një shembull ku tregojmë se si ligjet ndikojnë në jetën tonë. Ligji për mbrojtjen e ambientit ka një rol shumë të rëndësishëm, sepse nëse jetojmë në një ambient të ndotur, kjo do ta përkeqësonte gjendjen tonë shëndetësore. Qytetarët e Obiliqit kanë një vend shumë të bukur, por ajri në atë qytet është shumë i papastër dhe për këtë arsye qytetarët i vuajnë pasojat. Ne sugjerojmë që të bëhet një ligj i ri, i cili me automatizëm e ndalon hapjen e fabrikave apo çfardo qoftë tjetër që ndot ajrin brenda vendeve të banueshme nga qytetarët. Duke iu falenderuar ditës së sotme, ne e kuptuam rëndësinë të cilën e ka Kuvendi i Kosovës, prandaj edhe kemi vendosur ta shkruajmë këtë artikull, në mënyrë që t'i vetëdijësojmë edhe të tjerët për këtë fakt.



Puna e grupit na bëri shumë bashkëpunues



Gazetarë, të cilët lënë gjurmë me shkrime e artikuj

VOTA BËN NDRYSHIMIN

ORGESA (10), AURELA (10), RINESA (10), LORIANA (10), ERJON (10), LAURENT (10), DIELLON (10),
ENSAR (10)


Ne, disa nga nxënësit e klasës V-3 nga shkolla „Mustafë Venhari“, kemi kuptuar se zgjedhjet janë shumë të rëndësishme për jetën tonë. Për më shumë, lexojeni artikullin

Në demokraci të gjithë jemi të barabartë. Edhe ne si fëmijë i kemi të drejtat tona. Në vijim do ta tregojmë një shembull.


Bora është një vajzë 12 vjeçare, së cilës i pëlqen shumë të lexoj libra. Gjatë kohës së lirë ajo lexon librin që dëshiron, sepse ka të drejtë për të zgjedhur. Mirëpo, Bora nuk mund të marrë pjesë në procesin zgjedhor, sepse ende nuk i ka mbushur 18 vjet. Kur ajo ta arrijë moshën e duhur, do të mund të votoj dhe do të jetë më e pjekur dhe më e vetëdijshme për vendimet e saja. Vota është shumë e rëndësishme, sepse me anë të saj zgjedhen përfaqësuesit e vendit, të cilët pastaj marrin vendime për mënyrën e funksionimit të shtetit tonë.




Grupi i gazetarëve të ardhshëm




Zëri i popullit dëgjohef në demokraci



Përfaqësuesit i zgjedh populli




Voto edhe ti!



Ne, fëmijët jemi ardhmëria e vendit

NE, NXËNËSIT AKTIV TË KOSOVËS

ANISA (10), ENDRINA (10), ENGJËLL (10), ASTRIT (10), SHABAN (10), ANIS (10), DREN (10), RINË (10),
RINESA (10)



Ne jemi nxënës nga klasa V-3 nga shkolla „Mustafë Venhari“ në Vushtrri. Më poshtë, me shumë përkushtim në artikullin tonë kemi shkruar për mënyrat se si nxënësit mund të jenë aktiv në demokraci

Grupi ynë ka dhënë ide se çfarë mund të bëjmë ne për të ndihmuar dhe zhvilluar demokracinë e vendit tonë. Ne kemi mësuar se ta respektojmë ligjin është një nga gjërat më të rëndësishme. Sepse, përmes ligjeve neve na sigurohen të drejta të shumta.

Ne kemi të drejtë të luajmë, të shkollohemi, të votojmë kur t'i mbushim 18 vjet, të argëtohemi, të shoqërohemi, të kemi emër dhe mbiemër, etj. Por, për t'i plotësuar këto të drejta ne kemi përgjegjësi të mësojmë, të shkojmë në shkollë, të respektojmë të tjerët, të kujdesemi për ambientin që ai të jetë sa më i pastër e shumë përgjegjësi të tjera.

Si nxënës aktiv ne mund të ngrisin zërin tonë në shkollë, në shtëpi, në kurse, etj. Siç e përmendëm më lart, ne si nxënës kemi mundësi të jemi aktiv në shkollë, në lagje dhe në komunitete ku ne bëjmë pjesë. Mirëpo, mundësi tjetër ku ne mund të jemi aktiv është edhe përmes punës vullnetare.

Grupi ynë, gjithashtu ka biseduar për ndryshimet që ne mund t'i sjellim në shkollë. Pasi që ne nuk kemi laborator të biologjisë në shkollën tonë, ne kemi dhënë disa ide se si mund ta krijojmë një.



Ideja që ne të gjithë u pajtuam ishte t'i kontaktojmë nxënësit e tjerë të klasës së V-të dhe t'i kontaktojmë edhe mësueset dhe prindërit për t'ia dërguar kërkesën me shkrim drejtorit të shkollës sonë. Nga drejtori i shkollës me anë të kësaj letre, ne do të kërkonim bashkëpunim dhe përkrahje që ta formojmë laboratorin që do të na ndihmonte shumë në mësim.



Autorët e artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Mustafë Venhari“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Vushtrri